

VENDIM
Nr. 625, datë 29.7.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 407, DATË 8.5.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NJË REGJIMI KONTROLLI PËR TË
GARANTUAR RESPEKTIMIN E RREGULLAVE TË POLITIKAVE
MENAXHUESE NË PESHKIM”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 72, pika 8, 74, pika 3, 82, pika 2, 101, pika 2, pika 3, 113, pika 1, 116, 118, pika 3, dhe 135, pika 1, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 33, të vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 33/1, me këtë përmbajtje:

“33/1. Pajisja MTU (*Mobile Transceiver Unit*), për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, jepet falas nga ministria deri më 31 dhjetor 2020, për të gjitha anijet mbi 12 metër, të regjistruara në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit.

Fondi për blerjen e pajisjes që jepet falas përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2020.”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe